



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.1/2022**

**GJYKATA KOMERCIALE**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Krenar Berisha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Shpk “E...” me nr. biznesit ....., me pronar K.R, të cilin e përfaqëson av. A.I nga Vitia, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës- Ministria e Financave - Administrata Tatimore e Kosovës, e cila përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Dega Viti - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.61/2006, të datës 22.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.10.2022, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave- Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega Viti , Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil C.nr; 61/2006, të datës 22.11.2017 dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka vendosur si në vijim;

**I. MIRATOHET** – si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K.R, pronar i kompanisë “E...” shpk, me seli në Viti, dhe **DETYROHET** e paditura Qeveria e Kosovës – Ministria e Financave - Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që për dëmin e shkaktuar paditësit me dt 16.05.2005, nga e paditura Administrata Tatimore e Kosovës , e ka bërë përmbarimin në mënyrë kundërligjore, ashtu që me dt 16.11.2005, paditëses në mënyrë të kundërligjshme ia konfiskuar sendet: 1. Kamion ‘’ M..., me numër .... viti i prodhimit 1981, 3 makina për larjen e enëve të markës K..., 71 thasë me sheqer nga 50 kg, dhe një pirun për ngritjen e peshave, që të gjitha llogariten në vlerën prej 5.514 euro, duke llogaritur edhe kohën e kaluar nga data e përmbarimit i dt 16.11.2005 deri me datën e ekspertizës me datën 05.07.2017 , iu ka shtuar edhe kamata e llogaritur prej 3.589.22 euro, e gjithë dëmi i shkaktuar është 9.103.22 euro.

**OBLIGOHET**-e paditura që paditësit t’ia kompensoj dëmin në shumën prej 9.103.22 euro ( nëntmijë e njëqind e tri dhe njëzetmit e tri dhe njëzet e dy euro ) , në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi , me kamatë prej 8 % duke filluar nga data 22.11.2017 e deri

në pagesën përfundimtare nën kanosjen e dhunës përmbartimore.

**OBLIGOHET**- e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore për padi 156 euro, për taksa gjyqësore shumë prej 52 euro, ankesë kundër aktvendimit shumë prej 312 euro, taksën për ankesë 100 euro, për përfaqësim në 7 seanca të plota shumë nga 200 euro gjithsej 1.400 euro dhe tri seanca të shtyera nga 100 euro gjithsej 300 euro , dhe një parashtresë drejtuar të paditurës ATK në shumën prej 160 euro, gjithsej për pages shumë prej 2480 euro në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kanosjen e dhunës përmbartimore.

**II. REFUZOHET** – kerkesëpadija e paditëses për shpenzimet e procedurës për shumë prej 965 euro si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, ashtu që të priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan- Dega Viti , C.nr; 61/2006, të datës 22.11.2017, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqit paditësi me propozim që të refuzohet ankesa e paditurit dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-, C.nr; 61/2006, të datës 22.11.2017.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 dhe 195 të LPK-së gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi pranë gjykatës së shkallës së parë me datë 11.10.2005, ka paraqitur padi kundër të paditurit për përmbushjen e detyrimit në emër të dëmit të shkaktuar.

Gjykata Themelore në Gjilan- Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm - Divzioni Civil, me aktgjykimin e ankimuar ka vendosur që të obligoj të paditurën që paditësit për dëmin e shkaktuar, nga përmbartimi kundërligjor me të cilin ia konfiskuar një kamion M... nr. ...., 3 makina për larjen e enëve, 71 thasë për sheqer dhe një pirunë për ngritjen e peshave, në shumë totale prej 5.514 euro, duke llogaritur nga koha e përmbartimit 16.11.2015 deri në datën e kryerjes së ekspertizës 05.07.2017, si dhe kamatën e arritur në lartësinë prej 3.589.22 euro, përkatësisht në shumë e gjithmbarshme dëmin e shkaktuar në lartësi prej 9.923.22 euro, me kamatë prej 8 % , duke filluar nga data 22.11.2017 e deri në pagesën definitive në emër të borxhit t'ia paguaj shumë prej 5.168,00 euro, me kamatë ligjore prej 8% , duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë, si dhe e ka obliguar të paditurën që ti paguaj paditësit edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2.480 e euro. Ndërsa në pikën e dytë të dispozitivit e ka refuzuar kërkesë padinë e paditësit për shpenzimet e procedurës për shumë prej

965 euro si e pa bazuar, me arsytim se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor: si raporti i ATK-së me nr 0504 i datës 05.10.2004, raporti i Policisë së Kosovës – Krimeve Ekonomike 23.02. 2006, raporti ATK-UNMIK datës 16.09.2005 dhe 21.11.2005, regjistri- lista e pasurisë së konfiskuar 16.11.2005, mendimi dhe konstatimi i ekspertit I.T, deklaratat e dëshmitarëve R.K dhe E.A të dhëna në shqyrtim gjyqësor, ka vërtetuar faktin se paditësja ka pësuar dëme materiale si pasojë e veprimeve të kundërligjshme të të paditurës andaj mbi këtë bazë e ka detyruar të paditurën që paditëses t ia kompensoj dëmin siç është vendosur në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, në kuptim të nenit 154 par 1, 185 par 1 dhe 189 par 1 të LMD-së. Ndërsa për kërkesën aksesore të paditësit (kamatën prej 8 %) gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 382 të LMD-së. Kurse për shpenzimet procedurale gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë nuk mund t'i pranon si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me të meta thelbësore nga neni 182.1 lidhur me nenin 17, 19 dhe 182.2 pika f), të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, i rezultoi se gjykata e shkallës së parë nuk i ka zbatuar në tërësi dispozitat e LPK-së, që i referohen kompetencës së gjykatës me rastin e vendosjes lidhur me kërkesëpadinë e paditësit. Ngase me nenin 17 paragrafi 1 të LPK-së është paraparë se *“Gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëher pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur, e për më tepër edhe sipas nenit 19 të të njëjtit ligj është paraparë se “Secila Gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën vet lëndore”*. Në këtë drejtim, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë nuk është i pranueshëm ngase ka vendosur për kërkesëpadinë e paditësit duke mos vlerësuar kompetencën e saj lëndore. Ngase nga aktgjykimi i ankimuar në rastin konkret rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me borxhin, i cili ka derivuar nga raporti detyrimor – kontraktual në çështjet e afarizmit të ndërsjelltë, e ku të dyja palët janë persona juridik, andaj kompetenca lëndore është përcaktuar me Ligjin Për Gjykatën Komerciale (Ligji nr.08/L-015) respektivisht neni 13, e poashtu të njejtat kanë qenë të rregulluar edhe me Ligjin mbi Gjykatat.

Kolegji i kësaj gjykate, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktgjykimit të ankimuar ka gjetur se nuk mund të pranohet si i rregullt qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me mënyrën e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk i ka evituar pengesat e natyrës procedurale, që ndërlidhen më çështjen e lejueshmërisë së procesit gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë e që ndërlidhet me kompetencën e saj lëndore, për të vendosur përkitazi me çështjen e ngritur me padinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë, në rishqyrtimin e çështjes duhet të ndërmarr veprimet e duhura procedurale, ashtu që në shqyrtimin paraprak të padisë apo eventualisht në pamundësi për të vlerësuar në këtë fazë, në shqyrtim të çështjes, të evitohet dilemat përkitazi me kompetencën e saj

lëndore, gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësoj nëse ka kompetencë lëndore për të vendosur përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit.

Për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljes së dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore nga neni 182.2 pika f), gjykata e dhomës së shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që të priset aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të rikthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Andaj, duke pasur parasysh të gjeturat e mësipërme, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprjë sipas vërejtjeve të dhomës së shkallës së dytë, të eliminojë shkeljet e lartcekura ashtu që në radhë të parë të vlerësoj për ekzistimin apo jo të kompetencës së saj lëndore, dhe pasi të heq dilemat lidhur me kompetencën e saj lëndore, të mund të lëshohet në vlerësimin e besueshmërisë së kërkesave të paditësit dhe pastaj mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e duke zbatuar drejtë edhe të drejtën materiale, të nxjerr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe 195 parag.1 pika (c) e LPK-së, Gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E KOMERCIALE-Dhoma e Shkallës së Dytë,  
K.DH.SH II.nr.1/22 dt.13.10.2022**

**KRYETARI I KOLEGJIT-GJYQTARI  
Faton Bajrami**